Koordinatori për të drejtat e fëmijëve

Në kuadër të zyrës komunale për të drejtat e njeriut ekziston edhe koordinatori për të **drejtat e fëmijëve**. Ky koordinator për të drejtat e fëmijëve bashkëpunon me zyren për barazi gjinore, policinë dhe organet tjera që kanë të bëjnë më të drejtat e fëmijëve.

Kjo zyre trajton të gjitha problematikat që kanë të bëjnë më fëmijët dhe shkeljet e të drejtave të tyre që ju bëhen qoftë në shkollë, shoqëri dhe familje, duke i adresuar të gjitha këto shkelje të të drejtave të fëmijëve përmes grupit veprues lokal qe njihet si "Task forcë"(Forca vepruese).



Kjo task forcë është e përbërë nga : Policia e Kosovës, psikologu, pedagogu, përfaqësues të shoqërisë civile, qendra për punë sociale etj).

Task Forca shqyrton bashkarisht të gjitha rastet dhe ndërrmer masa në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse. Zyrat e koordinatorit për të drejtat e fëmijëve ndodhen në kuadër të kuvendit komunal, në Komunat Pejë, Gjakovë, Ferizaj dhe Mitrovicë.

Ti ke të drejtë në kujdes shëndetësor me cilësi të mirë, ujë të sigurt, ushqim me kalori dhe mjedis të pastër!

Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) ekzistojnë në të gjitha komunat e Kosovës dhe ato janë në shërbim të të gjithë pacientëve 24 orë.

Në këto qendrapunojnë mjekët specialist të përgjithshëm të cilët trajtojnë pacientë me probleme të ndryshme shëndetësore.

Ata mund t'i kontaktoni në çdo kohë për të marrë shërbimet e tyre shëndetësore.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Pejë ,Shërbimi i Emergjencës: Tel 039 432 772

Qendra e Mjekësisë Familjare në Gjakovë:
Tel. 0390 321-578

Qendra e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë:
Tel. 028- 534-422,
Shërbimi i emergjencës. Tel. 028-532-652

Qendra e Mjekësisë Familjare në Ferizaj:
Tel. 0290/320-053, urgjenca 194

Ti ke të drejtë të jesh pjesë e aktiviteteve të ndryshme argëtuese që komuna jote organizon!

Të gjithë fëmijët, pa dallim moshe, gjini, feje, race apo kombësie kanë mundësi të kyçen në aktivitet të ndryshme kulturore dhe sportive që komuna e tyre organizon përmes drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport. Ky drejtorat mbështet dhe organizon aktivitete kulturore, rinore dhe sportive brenda territorit të komunës.

Më shumë informacione gjeni duke vizituar ueb faqet e këtyre drejtorive:

Pejë:
http://kk.rks-gov.net/peje/Departments/Kulture-,-Rini-dhe-Sport.aspx

Gjakovë:
https://kk.rks-gov.net/gjakove/Municipality/Departments/Education-and-Culture.aspx

Ferizaj:
https://kk.rks-gov.net/ferizaj/Municipality/Departments/Kulture,-Rini-dhe-Sport.aspx

Mitrovicë:
http://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Departments/Local-Infrastructure.aspx

Gëzoni të drejtat e juaja!!!

Syri i Vizionit | Save the Children

Syri i Vizionit | Save the Children

Informatori për të drejtat e fëmijëve

Gëzoni të drejtat e juaja!!!



Nëse të drejtat e tua shkelen - ti ke të drejtë të ankohesh!

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) është institucion i pavarur.

Institucioni i Avokatit të Popullit shqyrton ankesat e paraqitura lidhur me pohimet për shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autoritetit nga institucionet publike të Kosovës.

Njësia për të drejtat e fëmijëve (NDF) është zyra e veçantë në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit që merret me mbrojtjen, promovimin, vëzhgimin dhe zhvillimin e hetimeve lidhur me shkeljet e të drejtave të fëmijëve nga ana e institucioneve publike.

Këtu shqyrtohen dhe hetohen ankesat individuale të bëra nga fëmijët apo nga përfaqësuesit e tyre si dhe ndërrmiren veprimet përkatëse në drejtim të zgjidhjes së tyre.

Të gjitha shërbimet dhe këshillat juridike në IAP jepen falas.

Çdo fëmijë apo përfaqësues i fëmijëve i cili dëshiron të kontaktojë me NDF mund ta bëjë këtë përmes numrave të telefonit 038/ 223 -782, 038/223-783, 038/223-784 apo 038/223-789, ose drejtpërsëdrejti të kontaktojë me këshilltarët ligjor të NDF-së në Institucionin e Avokatit të Popullit në Prishtinë, adresa: Rr.Enver Maloku, nr.28-Bregu i Diellit, Prishtinë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka zyre dhe në këto komuna:

Zyra rajonale në Mitrovicë
028 530 -138
Sheshi " Agim Hajrizi", p.n.
Ndërtesa e Administratës Tatimore Rajonale, 40000 Mitrovicë

Zyra rajonale në Gjakovë
0390 327 698
Rr. "UÇK-së", pn.
Përballë KRU "Radoniqi",
50000 Gjakovë

Nën zyra në Mitrovicë
045 455- 319
Ndërtesa e Zyrës Administrative për Mitrovicën veriore
Lagjja e Boshnjakëve, 40000 Mitrovicë

Zyra rajonale në Ferizaj
0290 326 032
Ndërtesa e Komunës (kati përdhes),
70000 Ferizaj

Zyra rajonale në Pejë
039 432 931
Rr."Mbretëresha Teutë", nr. 57
Ndërtesa e Komunës, Kati i 3, nr. 3
30000 Pejë

Ti ke të drejtë në arsim cilësor!

Drejtoria e Arsimit Komunal bën menaxhimin dhe koordinimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë si dhe inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë.

Drejtoria e Arsimit komunal gjithashtu miraton rregulloret për sjelljen dhe disciplinën e nxënësve në çdo institucion arsimor, pasi të ketë marrë më parë propozimet e këshillit të shkollës dhe komentet e drejtorëve për këto rregullore. Drejtoria e Arsimit gjithashtu ka për detyrë të nxisë bashkëpunimin në mes të mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore, si dhe të institucioneve arsimore dhe familjes.

Drejtoria e Arsimit gjithashtu duhet të ndërrmarë masa të sigurimit të ambienteve rrethuese, urbane apo rurale, ku është e vendosur shkolla e që ato të përmbushin të drejtën e juaj që ju të keni një mjedis të sigurtë shkollor. Drejtoria e Arsimit gjithashtu organizon fushata dhe programe për sigurinë në rrugë, fusha, nxitjen e shtimit të shëndetit për të shmangur përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, si dhe aksione kundër duhanit dhe formave të abuzimit me drogë.

Nëse keni ndonjë vërejtje për Drejtorinë e Arsimit ata mund ti kontaktoni në numrat e shënuar më poshtë:

Drejtoria e Arsimit në Pejë - Kuvendi komunal, Tel: 039-431 658
Drejtoria e Arsimit në Gjakovë - Kuvendi komunal Tel: 0390 323 055
Drejtoria e Arsimit në Ferizaj - Kuvendi komunal, Tel: 0290 321 287
Drejtoria e Arsimit në Mitrovicë - Kuvendi komunal, Tel: 028 530 521

Ti ke të drejtë në siguri kudo që je; në shtëpi, në rrugë apo në shkollë!

Policia e Kosovës ka për qëllim strategjik mbrojtjen e të drejtave dhe lirinë e njeriut.

Në kuadër të Policisë së Kosovës, ekziston drejtoria e policisë në bashkësi dhe preventivë, respektivisht policimi në bashkësi. Ky njësit funksionon në të gjitha stacionet policore të Kosovës. Ky njësit kryen ka për qëllim të forcojë nivelin e bashkëpunimit, identifikimin e probleme të bashkësive dhe keqbërësve, parandalimin e dukurive negative në bashkësi, përmirësimin e sigurisë në trafikun rrugor dhe zgjidhjen e problemeve potenciale të cilat cenojnë sigurinë e përgjithshme.

Kontaktoni policinë e Kosovës në çdo kohë:
në vala: 192, ipko: 922, fix: 92

Drejtoria e Policisë në bashkësi dhe Preventivë:
Tel. 038 50 80, 1250

Vizitoni ueb faqen e policisë për më shumë informacione: **http://www.kosovopolice.com/**

Ti ke të drejtë për një standard jetese që e plotëson dhe mundëson rritjen tënde fizike, mendore dhe sociale!

Qendra për Punë Sociale

Është institucion publik profesional në nivel komunal, e që ka mandatin e mbrojtjes së banorëve që kanë nevoja sociale pa dallim gjinie, moshe, nacionaliteti apo feje. Qendra për punë sociale ka një personel profesional me kualifikime përkatëse dhe të trajnuar në fushën e shërbimeve sociale. Qendra për punë sociale merret edhe me mbrojtjen e fëmijëve të këtyre kategorive:

- Fëmijët pa kujdes prindërorë (fëmijët jetim, të braktisur, të gjetur, dhe fëmijët përkohësisht pa kujdes prindërorë)
- Fëmijët më aftësi të kufizuar
- Fëmijët e keqtrajtuar
- Fëmijët me sjellje asociale
- Fëmijët në konflikt me ligjin
- Fëmijët si viktima të dhunës në familje
- Fëmijët si viktima të trafikimit
- Fëmijët si viktima të krimeve seksuale
- Fëmijët e shtyrë në punë të rrezikshme
- Fëmijët si përdorues të substancave narkotike
- Fëmijët e rrëmbyer

Qendra për punë sociale mund të ofrojë forma të ndryshme të mbrojtjes për këto kategori të ndjeshme:

- Kujdestari
- Strehim (familjar dhe rezidencial)
- Bashkim familjar
- Adoptim
- Përkrahje financiare familjeve për fëmijët me aftësi të kufizuara
- Zbatimi i masës edukative, kujdesi i shtuar nga ana e organit të kujdestarisë
- Këshillimet me familjen e fëmijës së rrezikuar

Qendrat për punë sociale mund ti kontaktoni në këto adresa:

Pejë: rr. Bajram Kelmendi, telefoni kujdestar: 049 786 522 (24 orë në dispozicion); Tel: 039 433 473

Gjakovë: rr. Marin Barleti.p.n, tel. 0390 323 210; e-mail: qpsgjakove@gmail.com

Ferizaj: rruga Vëllezërit Gervalla, nr.01, telefoni kujdestar 045 244 315 (24 orë në dispozicion) tel/ 0290 327 525; e-mail: qpsferizaj25@gmail.com

Mitrovicë: rr. Vëllezërit Dragaj p.n. Tel: 028535 440